

**AKT I THEMELIMIT**  
**I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SM Holdings”**

Sot, më 28/02/2024, në Tiranë, palët e mëposhtme (referuar në tekstu kolektivisht si “**Ortakët Themelues**”, ose individualisht secili si “**Ortaku**”) bien dakord të miratojnë Aktin e Themelimit, si më poshtë :

- Sonja Sadiku**, shtetase shqiptare, lindur në Lushnje, më 19.04.1996, mbajtëse e Letërnjoftimit nr. 032499080, me nr. Personal J65419032I.
- Mario Nikollı**, shtetas shqiptar, lindur në Lezhë, më 22.05.1993, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 037591145, me nr. Personal J30522066U.

**I. Themeli**

- Ortakët themelues vendosën për themelin e shoqërisë " **SM Holdings** " Sh.p.k, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar ("**Shoqëria**").
- Zyrat qëndrore të Shoqërisë ndodhen në adresën : Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga “Ukraina e lirë”, katër 1, apartamenti 4, pallati 1, perballe Ambasadës së Kosovës 1001, Tiranë, Shqipëri.
- Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar.

**II. Objekti**

Objekti i veprimitarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

- Dhenie me qera te pasurive te paluajtshme te veta ose te marra me qera.
- Sipas legislacionit ne fuqi, shoqeria ne menyre qe te arrije objektivat e saj mund te kryeje aktivitetet te konsideruara te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise.
- Shoqëria do të kryejë çdo veprimtar që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.
- Shoqeria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standardet më të larta të etikës.

**III. Statuti**

Ortakët Themelues me anë të kësaj deklarojnë miratimin e Statutit të Shoqërisë .

**IV. Kapitali Themeltar**

1. Kapitali fillestari i Shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) Lekë. Cdo ortak zoteron 1 (një) kuotë me një vlerë të përgjithshme nominale në proporcional me kontributin e cdo ortaku në kapitalin e Shoqërisë

Ortakët zoterojnë kapitalin si më poshtë:

- **Sonja Sadiku** – 50 % 5000 (pesë mijë) Lekë
- **Mario Nikollı** – 50 % 5000 (pesë mijë) Lekë

2. Kuotat janë të zakonshme dhe secili ortak ka të drejta votimi *proporcionale* me vlerën nominale të çdo kuote .
3. Kapitali i Shoqërisë paguhet plotësisht dhe nënshkruhet nga Ortakët Themelues.

#### V. Administratori

1. Shoqëria menaxhohet nga 1 (një) Administrator i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë te çdo pale e tretë. Numri i Administratorëve mund të ndryshohet nga Asambleja e Përgjithshme .
2. Administratori do të jetë përgjegjës për punët e përditshme të Shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në Statut, ligjin e aplikueshëm dhe nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të riemërohet. Administratori i parë i Shoqërisë është:
  - **Sonja Sadiku, shtetase shqiptare, lindur në Lushnje, më 19.04.1996, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 032499080, me nr. Personal J65419032I.**

*Akti i Themelimit është hartuar në 3 ( tre ) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Akti i Themelimit është hartuar në pajtim me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.*

Ortakët

MARIO NIKOLLU

  
SONJA SADIKU



## STATUT I SHOQERISE “SM Holdings” SH.P.K.

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

Sot, me 28/02/2024, në Tiranë, personat e meposhtem:

**Znj. Sonja Sadiku**, shtetase shqiptare, lindur me 19.04.1996 ne Lushnje e banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 032499080, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

**Z. Mario Nikollı**, shtetas shqiptar, lindur me 22.05.1993 ne Lezhe e banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 037591145, madhor e me zotesi te plote per te vepruar;

ne përputhje me LigjinNr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratuan këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

**Kreu I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 28/02/2024, themeluesit e mësipërm, vendosëm të krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar **“SM Holdings” SH.P.K.**

**Neni 2**  
**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Dhenie me qera te pasurive te paluajtshme te veta ose te marra me qera.
- Sipas legjislacionit ne fuqi, shoqeria ne menyre qe te arrije objektivat e saj mund te kryeje aktivitete te konsideruara te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e ***pacaktauar dhe/ose e pakufizuar.***

**Neni 4**  
**Selia**

- Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga “Ukraina e lirë”, kati 1, apartamenti 4, pallati 1, perballe Ambasadës së Kosovës 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

## **Kreu II**

### **Kapitali**

#### **Neni 5**

##### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestari i shoqërisë është **ALL 10,000 (dhjetë mijë lekë)** dhe zotërohet në masën 50% nga **Sonja Sadiku**, zotëruese e **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **5000 (pesë mijë lekë)** dhe 50% nga **Mario Nikollı** zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **5000 (pesë mijë lekë)**.

Kontributi i ortakëve është në para.

#### **Neni 6**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Çdo disponim ne favor te një pale te trete nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet te gjallëve duhet te behet ne forme notariale dhe te regjistrohet. Ne rastet e transferimit te pjesëve te kapitalit me kundërshpërblim, ortaket e tjerë kane te drejtëne e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpérndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Per sa kohe qe kapitali themeltar i Shoqerise zotërohet nga një ortak i vetëm, ky i fundit do te ushtroje kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

## Neni 9

### Mënyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë pér çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **Neni 11** **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zotëruar te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, pér ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, pér çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet etjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

### **Neni 12** **Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim pér:vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndajtij nga shoqëria; dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në t ë njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13** **Administrimi**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë pér një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi: **Znj. Sonja Sadiku**, shtetase shqiptare, lindur në Lushnje, më 19.04.1996, mbajtëse e Letërnjoftimit nr. 032499080, me nr. Personal J65419032I; madhor e me zotësi të plotë pér të vepruar.

**Kreu IV**  
**Viti finansiar-ekspertet**

**Neni 14**  
**Viti Financiar**

Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

**Neni 15**  
**Ekspertet**

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit reportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

**Neni 16**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë se Ortakete; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrine likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri ne likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftës isë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 17**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**Neni 18**

**Baza**

**Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 19**

**Mosmarrëveshj**

**et**

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhpër çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te tretëve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt u hartua ne gjuhen Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortakët themelues si vijon:

**ORTAKËT  
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“SM Holdings”**



SONJA SADIKU

